



Raport Studimor

Transparenca dhe menaxhimi financiar në Universitetet Publike

Viti akademik 2018 – 2019

Realizuan:

Autor: Rigels Xhemollari

Ekspertë monitorimi:

Besjana Hysa

Ines Mulellari

Çeldo Brahimaj

Ekipi i monitoruesve:

Anida Hana

Armando Hysenaj

Livia Kili

Arestina Skënderi

Elona Tutaj

Mirsada Kuka

Anila Salianji

Fatjon Biba

ISBN:

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert. Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

TABELA E PËRMBAJTJES

- 1.** HYRJE.....
- 2.** BORDET E ADMINISTRIMIT NË IAL-TË PUBLIKE.....
- 3.** METODOLOGJIA.....
- 4.** GJETJET KRYESORE.....
- 5.** ANALIZË E SHPENZIMEVE NË 7 UNIVERSITETE PUBLIKE
 - 5.1 Kategoria " Shpenzime Personeli"
 - 5.2 Kategoria " Investime"
 - 5.3 Kategoria "Blerje mallrash"
 - 5.4 Kategoria "Sigurimi i Shërbimeve"
 - 5.5 Kategoria "Bursa dhe transferta për subvencione të tjera"
 - 5.6 Shpenzimet për strukturat administrative të IAL-ve publike
 - 5.7 Pasqyrë e plotë e shpenzimeve të 7 universiteteve publike në periudhën 15 shkurt – 31 Tetor 2019
- 6.** KONTRATA DHE KLIENTË TË UNIVERSITETEVE
- 7.** PORTALI U-TRANSPARENCA.AL
- 8.** REKOMANDIME

1. HYRJJE

Qëndresa Qytetare është një organizatë e fokusuar tek fuqizimi i rolit të qytetarit në shoqëri dhe synon përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet angazhimit dhe aktivizmit qytetar. Nisur nga mungesa e shërbimeve ndaj studentëve në universitetet publike, tarifat e larta që aplikohen në to e në tërësi nga ankesat e artikuluara gjatë protestës së studentëve në muajin dhjetor 2018, vendosëm të kryejmë këtë monitorim me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert.

Në kuadër të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ndryshimeve që institucionet e arsimit të lartë pësuan sa i takon menaxhimit financiar dhe administrimit, **Qëndresa Qytetare monitoroi shtatë universitete publike** me fokus investimet dhe nivelin e transparencës së tyre në raport me publikun dhe studentët për **periudhën 15 Shkurt deri më 31 Tetor 2019**.

Ky monitorim shërben për të hedhur dritë mbi mënyrën se si janë shpenzuar të ardhurat që grumbullohen nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat që vijnë nga buxheti i shtetit duke u munduar kështu t'i japë përgjigje pyetjes nëse reflektohen nevojat reale të studentëve apo kemi të bëjmë me një administrim jo efektiv të buxhetit vjetor të universiteteve?

Gjithashtu kjo nismë adreson një problematikë për të cilën qeveria, si rezultat i presionit të lartë të studentëve, në “Paktin për Universitetin”, për shkak të keq menaxhimit të parave, ndërmori masa duke zëvendësuar Anëtarët e Bordeve të Administrimit me figura publike si reflektim për më shumë efikasitet në menaxhimin e parave nga Anëtarët e Bordeve përfaqësues të MASR.

Qëndresa Qytetare nëpërmjet këtij monitorimi synon të nxisë llogaridhënien publike të universiteteve ndaj studentëve dhe të stimulojë një nivel më të lartë transparence, nisur dhe nga fakti që tashmë është krijuar edhe portali u-transparenca.al, një database që synonte të përmbante çdo informacion në lidhje me shpenzimet e universiteteve.

2. BORDET E ADMINISTRIMIT NË IAL-TË PUBLIKE

Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme.

3 Anëtarë, përfaqësues të institucionit publik të arsimit të lartë, përzgjidhen nga Senati Akademik i institucionit përkatës, 4 Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin do të jenë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike dhe emërohen nga ministri përgjegjës për arsimin.

Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë, të miratuar nga Bordi i Administrimit. Një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrit tri kandidatura.

Ministri përgjegjës për arsimin emëron një prej kandidaturave të paraqitura nga studentët. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kritere si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Ministri përgjegjës për arsimin emëron anëtarët e bordit për secilin institucion të arsimit të lartë.

Administratori është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i institucionit të arsimit të lartë për çështjet financiare dhe administrative. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kritereve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.

Në institucionet jopublike të arsimit të lartë administratori emërohet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve në statutin e institucionit. Administratori i institucionit publik të arsimit të lartë shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

3. METODOLOGJIA

Ekipi i monitoruesve të Qëndresës shfrytëzoi dhe gërshetoi një sërë burimesh të informacionit. Monitorimi u bazua në analizën ligjore të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë sa i përket organeve të administrimit financiar në universitete dhe shqyrtimit të të dhënave të përfuara nga **transaksionet e Thesarit**.

Gjetjet e analizuara të transaksioneve të Thesarit u pasuruan me të dhënat e përfuara nga shfletimi i **buletinit të prokurimeve publike**, ku duken qartazi kontratat dhe objektet e marrëveshjeve që titullarët e universiteteve publike lidhin me operatorë të tretë për shërbime dhe produkte në plotësim të nevojave të universitetit.

Njëkohësisht, plot **30 kërkesa për informacion** drejtuar universiteteve të përzgjedhura u dërguan në lidhje me buxhetin, investimet dhe destinacionin e parave të mbledhura nga tarifat e studentëve. Në konsideratë janë marrë për raport krahasimor edhe **gjetjet e raportit të KLSH** “Shërbimet Studentore në IAL-të Publike” për sa i përket administratës së fryrë të universiteteve.

Në shqyrtim janë marrë të dhënat e 7 universiteteve publike, konkretisht:
Universiteti i Tiranës (U.T)
Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan (U.E)
Universiteti “Fan S. Noli” Korçë (U.K)
Universiteti i Mjekësisë (U.M)
Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD)
Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër (U.SH)
Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)

4. GJETJET KRYESORE

- **1.4 milion euro** kanë shpenzuar **për investime** 7 universitetet ne 8 muajt e fundit, por vetëm 2900 euro janë shpenzuar për **zërin e studimeve dhe kërkimeve** (nga Universiteti "Fan Noli" Korçë, ndërsa 6 universitetet e tjera kanë shpenzuar 0 lekë për këtë zë)
- **UPT** rezulton universiteti me më shumë shpenzime të personelit dhe administratës, ku vetëm **në 8 muaj ka paguar 100.000 euro dieta, 70.000 euro karburant makine, 17.500 euro telefon/internet dhe rreth 160.000 euro shpërblime dhe honorare për stafin.**
- Universiteti i Tiranës ka shpenzuar në periudhën e monitorimit **3.2 milion euro për rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash** ku përfshihet rikualifikim i oborrit të Histori - Filologjikut në vlerën **170.000 euro** dhe rikonstruktim i Fakultetit të Ekonomisë në vlerën **2.9 milion euro.**
- **Siguria e godinave** zë sërish një nga zërat kryesorë të shpenzimeve të universiteteve, ku **Universiteti i Tiranës** ka shpenzuar **444.000 euro**, dhe **Universiteti Politeknik rreth 300,000 euro** për vitin 2019. **Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"** ka blerë kamera sigurie në vlerën **100,000 euro**, si edhe ka shpenzuar **152 000 euro për sigurinë e godinës.**
- **UPT** ka siguruar pasurinë me vlere **20 000 euro në një nga kompanitë e sigurimeve** por vlen të investigohet **kontrata 24,000 euroshe** e lidhur me një kompani ndërtimi për riparimin e dëmtimeve nga tërmeti, punim të cilin duhej ta mbulonte kontrata e sigurimit të pasurisë.
- **7 Universitete** kanë shpenzuar në total **16 000 euro për blerje librash** por **106 000 euro për karburant makine. Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër dhe Universiteti i Mjekësisë** nuk kanë blerë asnjë libër në 1 vit të plotë akademik.
- **UAMD** ka paguar 44.000 euro për shërbimin e printimit ndaj një kompanie, 97.000 euro për rikonstruksione dhe 16.000 euro për perde kundër diellit. Ndërsa Universiteti uigj Gurakuqi" ka shpallur tender për të blerë një "Rrufepritëse" në vlerën 45.000 euro.
- rtali **u-transparenca.al** nuk përmban të dhëna mbi prokurimet dhe kontratat e IAL-ve me tretët për vitin 2019. **Kjo mungesë u vështirëson studentëve të kuptojnë shpenzimet totale të universitetit** dhe raportin e shpenzimeve për mënyrën se si harxhohen paratë e tyre.

5. ANALIZË E SHPENZIMEVE NË 7 UNIVERSITETE PUBLIKE

Monitoruesit dhe ekspertët e Qëndresës Qytetare kanë kaluar në sitë dhe kanë përpunuar në mënyrë të thjeshtëzuar të gjitha transaksionet që kanë kryer shtatë universitetet publike duke përfshirë të gjitha kategoritë e shpenzimeve gjatë periudhës **1 Shkurt 2018 – 31 Tetor 2019, përkatësisht gjysmës së një viti akademik.**

Nëpërmjet kalimeve të vlerave tek të tretët apo personeli duke marrë në konsideratë edhe përshkrimin e çdo transaksioni, është bërë i mundur edhe evidentimi i pagesave dhe transfertave të dyshimta apo të pa justifikuar.

Ekipi i monitoruesve ka identifikuar një mori transaksionesh të ndara sipas kategorive të cilat nuk përputhen as me vlerat normale të pagesave, as me nevojat që mund të ketë një universitet publik, parë në raport me buxhetin e tij total.

Gjatë periudhës 15 Shkurt – 31 Tetor 2019 këto 7 Universitete kanë shpenzuar në total:

Universiteti	Lekë	Nr. Transaksioneve
Tiranës (U.T)	204,136,194 Lekë	257
“Aleksandër Xhuvani” Elbasan (U.E)	250,089,030 Lekë	162
"Fan S. Noli" Korçë (U.K)	178,449,401 Lekë	199
Mjekësisë (U.M)	24,210,160 Lekë	122
“Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD)	381,342,789 Lekë	968
“Luigj Gurakuqi” Shkodër (U.SH)	205,262,982 Lekë	351
Politeknik i Tiranës (UPT)	537,384,734 Lekë	978

Universiteti Politeknik i Tiranës ka shpenzuar më shumë në vlerë dhe njëkohësisht ka kryer dhe numrin më të madh të transaksioneve, duke u ndjekur ngushtazi nga UAMD, i cili ka shtuar ndjeshëm numrin e transaksioneve dhe është universiteti i dytë që ka shpenzuar më shumë për këtë periudhë.

Siç kuptohet nga tabela, shpenzimet e universiteteve sipas zërave të kategorive shkojnë pak a shumë në proporcion të rregullt me shpenzimet totale të secilit prej tyre. Vlen gjithashtu të theksohet se Universiteti i Mjekësisë ka shpenzime totale shumë më të ulëta se universitetet e tjera, jo vetëm se është universiteti më i ri i krijuar por edhe sepse ka një ndarje me të theksuar të shpenzimeve në Thesar me institucionet e tij të varësisë, që do të thotë kryesisht shpenzimet e bëra nga vetë U.M në Thesar janë kryesisht vetëm për pjesën e Rektoratit.

Sipas kategorive të shpenzimeve, universitetet kanë shpenzuar si më poshtë:

	Kategori	U.Tiranes	U. Politeknik i Tiranes	U. Durrësit	U. Korces	U. Shkodres	U. Mjekësisë	U.Elbasanit
II	Shpenzime personeli	30,818,187	270,677,665	197,801,923	102,501,170	121,205,215	14,217,231	135,020,512
III	Investime	13,924,775	109,673,526	27,955,928	1,180,880	109,676,377	0	3,144,215
IV	Blerje mallrash	78,973,545	49,208,207	27,078,489	13,569,585	20,366,050	945,565	9,622,766
V	Sigurimi i shërbimeve	67,484,487	44,097,263	20,659,681	18,712,156	17,257,713	8,002,921	28,258,424
VI	Transferta dhe Subvencione	1,282,096	7,372,505	61,429,730	2,274,630	800,927	1,020,443	1,216,176
VII	Të tjera	11,653,104	56,355,568	46,417,038	40,210,980	34,665,440	24,000	72,826,937
	Totali	204,136,194	537,384,734	381,342,789	178,449,401	205,262,982	24,210,160	250,089,030

5.1 Kategoria “Shpenzime Personeli”

Kategoria e shpenzimeve të personelit është ndër kategoritë që zënë peshën kryesore të shpenzimeve të universiteteve. Nga tabela e transaksioneve vihet re se universiteti që ka shpenzuar më shumë para për dieta dhe udhëtime ka qenë ai i Elbasanit me plot 12 427 542 lekë ndjekur nga UPT me 6 537 723 lekë. Ndërkohë Universiteti i Korçës “Fan Noli” ka shpenzuar më shumë para se universitetet e tjera për të paguar strukturat drejtuese akademike dhe administrative në vlerën 2 745 250 Lekë në 8 muaj.

Ajo që bie në sy në zërin e shpenzimeve të personelit është që Universiteti i Elbasanit nuk ka bërë asnjë shpenzim në zërin **2.3 “Paga me kontratë për kohë të kufizuar”** dhe **2.5 “Pagesa Anëtarët e Bordit të Administrimit dhe Senatit Akademik”**. **Anomalia e identifikuar edhe në vitet paraardhëse** ku të gjitha shpenzimet e pagave dhe honorareve në U. Elbasanit kalojnë në emër të F.Q, vijon të mbetet shqetësuese.

Kategori /Nënkategori	U. Tiranës	U. Politeknik	U. Durrësit	U. Korçës	U. Shkodrës	U. Mjekësisë	U. Elbasanit
II Shpenzime personeli total	30 818 187	270 677 665	197 801 923	102 501 170	121 205 215	14 217 231	135 020 512
2.1 Paga	20 570 737	217 580 517	181 595 929	99 669 834	96 077 620	7 569 056	97 962 411
2.2 Honorare + Të tjera shpërblime për personelin	7 527 963	20 430 181	4 734 855	20 000	5 713 066	5 071 537	30 520 378
2.3 Paga me kontratë për kohë të kufizuar	141 852	19 741 721	6 291 597	322 377	11 776 954	1 333 383	0
2.4 Dieta Udhëtime	604 464	12 427 542	2 434 292	1 893 959	5 549 125	243 255	6 537 723
2.5 Pagesa anëtarët e Bordit Administrativ(+ Senatit)	1 973 171	497 704	2 745 250	595 000	2 088 450	0	0

5.2 Kategoria “Investime”

Gjatë vitit 2019, ndryshe nga vitet paraardhëse vihet re një rënie e shpenzimeve të universiteteve në zërin e rikonstruksionit të ndërtesave shkollore.

Dy zërat ku asnjëri nga universitet nuk ka bërë asnjë shpenzim këtë periudhë përkatësisht në kategorinë e investimeve janë zëri për **pajisje pastrimi dhe zëri për mjete transporti**. Pas denoncimit në media nga Qëndresa Qytetare të blerjeve të makinave luksoze dhe karburantit në masë nga universitetet, vihet re një kujdes i treguar nga drejtuesit e universiteteve në këtë zë të thesarit. Universiteti Politeknik i Tiranës ka shpenzuar 88,023,341 lekë në zërin **Mjete dhe Pajisje Teknike** dhe rreth 17,741,400 lekë për pajisje dhe orendi zyre.

I vetmi universitet që ka kryer shpenzime në zërin **Studime dhe Kërkime** me vlerën 359,000 All është Universiteti i Korçës.

	Kategori/Nënkategori	U. Tiranës	U. Politeknik	U. Durrësit	U. Korçës	U. Shkodrës	U. Mjekësisë	U. Elbasanit
III	Investime	13 924 775	109 673 526	27 955 928	1 180 880	10 967 637	0	3 144 215
3.1	Rikonstruksion i ndërtesave shkollore	1 181 730	3 908 785	19 395 463	136 680	7 444 077	0	1 581 000
3.2	Pajisje pastrimi	0	0	0	0	0	0	0
3.3	Mjete transporti (dhe Shërbime të tyre)	0	0	0	0	0	0	0
3.4	Mjete dhe pajisje teknike	12 743 045	88 023 341	0	685 200	3 053 160	0	1 563 215
3.5	Pajisje zyre dhe orendi të tjera	0	17 741 400	8 560 465	0	470 400	0	0
3.6	Studime dhe kërkime	0	0	0	359 000	0	0	0

5.3 Kategoria “Blerje mallrash”

Pavarësisht protestës së studentëve në Dhjetor 2018, universitetet kanë vazhduar të shpenzojnë për karburant për makinat e drejtuesve të tyre. Universiteti i Durrësit ka shpenzuar në 8 muaj 3 575 100 lekë të reja karburant ndërsa UPT 8 699 903 lekë po për të njëjtën periudhë. Nëse do të bëjmë një shpërndarje mujore, i takon që këto universitete të kenë shpenzuar rreth 500 mijë – 1 milion lekë të reja/muaj për karburant makinash.

Në kategorinë “Blerje Mallrash” Universiteti i Tiranës mban vendin e parë me shpenzime në vlerën 78,973,545 lekë, kryesisht të shpenzuara në zërin **Pajisje Informatike** duke u ndjekur në vend të dytë nga UPT me vlerën 49,208,207 lekë.

Ndërkohë Universiteti i Elbasanit vijon të mbetet problematik edhe sa i përket shpenzimeve për ujë të pijshëm ku ka paguar 3,510,056 lekë për këtë zë ndërsa UPT ka shpenzuar 11.839.051 lekë për energji elektrike për këtë periudhë 8-mujore të marrë në shqyrtim.

	Kategori/Nënkategori	U. Tiranës	U. Politeknik	U. Durrësit	U. Korçës	U. Shkodrës	U. Mjekësisë	U. Elbasanit
IV	Blerje mallrash	78 973 545	49 208 207	27 078 489	13 569 585	20 366 050	945 565	9 622 766
4.1	Energji elektrike	778 543	11 839 051	10 825 336	2 951 868	3 410 484	578 172	4 492 658
4.2	Karburant dhe vaj	0	8 699 903	3 575 100	575 236	28 114	0	176 264
4.3	Ujë	27 270	1 905 034	125 383	438 329	1 137 496	0	3 510 056
4.4	Ngrohje + Pastrim	4 123 895	0	0	3 284 933	2 290 540	0	0
4.5	Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	0	3 401 973	4 258 225	4 116 840	0	0	288 520
4.6	Shpenzime për prodhim dokumentacioni specifik	227 196	184 290	2 953 135	408 900	108 000	0	15 000
4.7	Libra dhe publikime profesionale	47 502	310 800	757 494	28 800	0	0	807 600
4.8	Materiale dhe shërbime operative	0	0	454 680	1 764 679	0	358 893	6 000
4.9	Pajisje Informatike	72 586 136	22 706 952	4 129 136	0	13 391 416	0	326 668
4.10	Materiale të tjera	1 183 003	160 204	0	0	0	8 500	0

5.4 Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”

Gjatë protestës së Dhjetorit 2018, kryeministri vendit hodhi akuza përgjate një takim me rektorët dhe dekanët se paratë e studentëve po shpërdoroheshin duke shpenzuar shuma të mëdha për kompanitë e sigurimit të godinave. Por pavarësisht këtij qëndrimi mediatik, nga monitorimi i Qëndresës Qytetare rezulton se drejtuesit e të gjitha universiteteve publike vazhdojnë të shpenzojnë shuma të mëdha të parave të studentëve për të lidhur kontrata për sigurinë e godinave.

UNIVERSITETI I TIRANËS

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Universiteti i Tiranës
Adresa	Sheshi “Nënë Tereza”, Godina e Rektoratit të UT
Tel/Fax	+355 4222 8070
E-mail	skerdi.dafa@unitir.edu.al
Faqja në Internet	unitir.edu.al
2. Lloji i procedurës: E hapur
3. Objekti i kontratës: Loti 1: “Shërbimi privat i sigurisë fizike të Universitetit të Tiranës”
4. Numri i referencës së procedurës: Loti 1: REF- 96235-11-27-2018
5. Fondi limit: Loti 1 – 97,296,215.74 (nëntëdhjetë e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e pesëmbëdhjetë presje shtatëdhjetë e katër) LEKE pa TVSH
6. Vlera totale përfundimtare e kontratës: 54, 558, 622.22 (pesëdhjetë e katër milion e pesëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e njëzet e dy pikë njëzet e dy) lekë me TVSH
7. Data e lidhjes së kontratës 07.03.2019
8. Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit

Emri	“TONI-SECURITY” SHPK
Adresa	Rr.“Lidhja e Prizrenit”, P.10/1, kati 1, Tiranë
Nr. NIPT	K94010201F

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

- 1.Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri	Universiteti Politeknik i Tiranes
Adresa	Sheshi “Nene Tereza” Nr 4,Tirane
Faqja në Internet	www.upt.al
2. Lloji i procedurës: Tender i Hapur
3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër Shërbimi Privat i Sigurisë Fizike të Universitetit Politeknik të Tiranës, viti 2019.
4. Numri i referencës së procedurës/lotit REF-93267-11-08-2018
5. Fondi limit: 43,452,659 (dyzetë e tre milion e katerqind e pesedhejte e dy mije e gjashteqind e pesedhejte e nente) leke pa TVSH.
6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (*duke përfshirë lotet opsionet dhe nenkontraktimin*):
36,735,750.45 (tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e tridhjetëe pesë mijë e shtatëqind e pesdhjet presje dyzet e pesë) leke (*me TVSH*).
Vlera e nenkontraktimit _____ me Tvsh Monedha _____
7. Data e lidhjes së kontratës 15.02.2019
8. Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit

Emri	“Myrto Security”sh.p.k., Nr. NIPT K23323401N
Adresa	Lagjja “Kastriot”, Rr. “Brigada e XI Sulmuese”, Godina e Albtelecom, Kati 3, Fier.

tendera për kamera sigurie.

Për ilustrim më poshtë gjeni kontratat e lidhura mes kompanive të sigurimit dhe universiteteve të marra në monitorim të përfuara nga buletini i prokurimeve publike. Ajo që vihet re është fakti se edhe pas protestës së studentëve dhe indinjimit të kryeministrit në takimin publik me dekanët dhe rektorët, universitetet vazhdojnë edhe këtë vit të shpenzojnë po të njëjtat shuma parash për të siguruar godinat e tyre. Përveç sigurisë fizike, universitetet aplikojnë kontrata siguracioni financiar dhe kanë shpallur

Universiteti i Tiranës ka nënshkruar një kontratë në 7 Mars për siguri godine në vlerën e 54,558,622 lekësh të reja ndërsa ai Politeknik në datën 15 Shkurt ka nënshkruar kontratë po për siguri godinash në vlerën 36,735,750 lekësh të reja për vitin 2019.

Duke mos mjaftuar kjo shifër kaq e lartë për sigurinë fizike UT ka nënshkruar edhe një kontratë në muajin nëntor në vlerën e 4.7 milionë lekë të reja për sigurimin e pajisjeve pranë kompanisë SIGAL, pra para që i mbivendosen shpenzimeve për sigurinë.

Gjithashtu në tabelën më poshtë Qendresa ka bërë transparente të gjitha transaksionet që universitetet kanë shpenzuar për këtë nënkategori shpenzimi për periudhën e marrë në monitorim.

Për sa i përket shpenzimeve për **Telefon dhe Internet** është **UPT që ka shpenzimet më të larta me vlerë rreth 2.2 milionë lekë të reja**. Ndërkohë vihen re ndryshime të dukshme në zërin e “Sigurimit të Ndërtesave”, ku kemi një rritje të dukshme të shpenzimeve të kryera nga UT dhe UPT, por një ulje të këtyre shpenzimeve të kryera nga UAMD.

	Kategori/Nënkategori	U. Tiranës	U. Politeknik	U. Durrësit	U. Korçës	U. Shkodrës	U. Mjekësisë	U. Elbasanit
V	Sigurimi i shërbimeve	67 484 487	44 097 263	20 659 681	18 712 156	17 257 713	8 002 921	28 258 424
5.1	Posta dhe shërbimi korrier	115 841	126 363	25 860	16 580	28 035	528 250	29 765
5.2	Telefon dhe internet	469 765	2 145 950	308 501	127 096	238 797	59 580	504 336
5.3	Pastrim dhe gjelbërim	0	0	0	0	0	0	0
5.4	Shërbime të tjera transporti	91 688	1 920 935	621 780	1 405 405	114 225	0	369 047
5.5	Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	39 078 595	24 100 698	6 380 432	12 178 968	14 385 408	2 330 056	18 688 984
5.6	Shërbime të tjera	2 748 980	1 156 405	0	3 141 468	0	96 740	1 224 572
5.7	Aktivitete sociale për personelin (dhe pjesëmarrje në evente e konferenca)	297 550	1 996 598	1 446 740	534 840	175 188	4 126 008	778 280
5.8	Mirëmbajtje ndërtesash	21 064 748	794 264	9 640 260	0	2 316 060	501 537	2 215 160
5.9	Instalim dhe mirëmbajtje rrjetesh informatike	2 444 620	11 086 050	915 384	683 837	0	49 950	4 448 280
5.10	Mirëmbajtje të tjera	1 172 700	770 000	1 320 724	623 962	0	310 800	0

5.5 Kategoria “Bursa dhe transferta për subvencione të tjera”

Në kategorinë e **Transferta dhe Subvencione** kemi një rritje të ulët të shpenzimeve nga të gjithë universitetet duke kulmuar tek Universiteti i Durrësit i cili nga 0 shpenzime që ka patur në periudhën e mëparshme ka kaluar në shifrën e konsiderueshme prej 61,429,730 lekësh. Kryesisht këto shpenzime janë bërë në zërin **Komisione Bankare dhe transferta te kthyera**.

	Kategori/Nënkategori	U. Tiranës	U. Politeknik	U. Durrësit	U. Korçës	U. Shkodrës	U. Mjekësisë	U. Elbasanit
VI	Transferta dhe Subvencione	1 282 096	7 372 505	61 429 730	2 274 630	800 927	1 020 443	1 216 176
6.1	Transferta për projekte	0	3 316 273	387 629	239 630	327 600	894 914	109 862
6.2	Kuota Anëtarësimi	60 048	2 503 487	418 000	0	100 000	117 326	163 500
6.3	Komisione Bankare	1 222 048	1 552 745	60 624 101	2 035 000	373 327	8 203	942 814
VII	Të tjera	11 653 104	56 355 568	46 417 038	40 210 980	34 665 440	24000	72 826 937
7.1	Mbështetje e studentëve dhe bursa studimi	0	56 355 568	43 639 262	39 543 000	34 665 440	0	72 826 937
7.2	Shpenzime gjyqësore	11 653 104	0	2 777 776	667 980	0	24 000	0

5.6 Shpenzimet për strukturat administrative të IAL-ve publike

Bazuar në të dhënat e KLSH strukturat organizative të universiteteve publike janë të fryra dhe si rrjedhim ato kanë rritur shpenzimet mbi të ardhurat. Raporti mes numrit të personelit akademik dhe atij administrativ le të kuptohet se shumica të

(në mijë lekë)

Institucion i Arsimit të Lartë Publik		UT	UBT	UMT	UAMD	ULGSH	UIQV	UFSNK
Detajimi i buxheti nga BA-2018	Fondi për IAL	1 161 693	682 185	525 585	488 824	385 836	338 714	285 000
	Fondi për Bursa	88500	17000	25000	20000	38006	17500	25227
	Grandi per mesimdhënie nga Buxheti I Shtetit	1 250 193	699 185	550 585	508 824	423 842	356 214	310 227
Planif. të ardhura dytësore PBA 2018-2020		1 237 416	318 288	459 482	405 372	231 011	335 237	128 905
Nr. Punonjësve Pedagog/ akademike		837	309	309	340	235	241	171
Nr. Punonjësve Administrative		311	151	98	111	78	86	62
Nr. Punonjësve Ndhmës dhe shërbimesh		86	113	25	96	31	32	25
Nr. Punonj. Gjithesëj		1234	573	432	547	344	359	258
Raporti punonjës administrat e shërbimesh, per pedagog		0.47	0.85	0.40	0.61	0.46	0.49	0.51
Shpenzimet e personelit te parashikuara nga IAL, për vitin 2018		1 477 098	685 881	517 104	654759	411768	429723	308826
Fonde për shpenzime personeli qe mbulohen nga te ardhurat		- 315 405	- 3 696	8 481	- 165 935	- 25 932	- 91 009	- 23 826
shpenzimeve per personelin ndaj te ardhurave (%)		-25,5%	-1,2%		-40,9%	-11,2%	-27,1%	-18,5%
Nr. I studenteve		28 394	9542	7 427	17591	7927	8801	4500
Tarifa mesatare per student		44	33	62	23	29	38	29

Burimi: MASR, përpunimi grupi i KLSH

mëdha të parave të studentëve shkojnë për pagesat e personelit administrativ dhe ndihmës administrativ.

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka në organikë 264 punonjës administrativë dhe ndihmës shërbimesh dhe vetëm 300 pedagogë duke shpenzuar në total **685.881.000 lekë të reja për paga punonjësish**, ndërsa UAMD ka 207 punonjës administrativë dhe vetëm 340 pedagogë. Pavarësisht kësaj strukture organizative të fryrë dhe shpenzimeve të larta për paga punonjësish, të gjitha universitetet e përfshira në monitorim kanë mungesa të theksuara në ofrimin e shërbimeve ndaj studentëve në numër dhe cilësi, sipas po të njëjtit raport.

Raporti punonjës administrate e shërbimesh, për pedagog për vitin 2018 ndryshon në varësi të universiteteve:

Universiteti	Pedagogë	Punonjës administrative
Universiteti Tiranës	837	397
Universiteti Bujqësor i Tiranës	309	264
Universiteti i Mjekësisë	309	123
Universiteti "Aleksandër Moisiu"	340	207
Universiteti "Luigj Gurakuqi"	235	109
Universiteti "Isamil Qemali"	241	118
Universiteti "F.S. Noli"	171	87

Një tjetër tregues i rëndësishëm është dhe raporti i shpenzimeve për personelin ndaj të ardhurave. Universiteti i Tiranës shpenzon **25% të të ardhurave për pagesat e personelit dhe për stafin administrativ**, Universiteti i Durrësit **41%** dhe Universiteti i Vlorës shpenzon **27% të të ardhurave**

5.7 Pasqyrë e plotë e shpenzimeve të 7 universiteteve publike në periudhën 15 Shkurt – 31 Tetor 2019

	Kategori/Nënkategori	U.Tiranes	U. Politeknik i Tiranes	U. Durresit	U. Korces	U. Shkodres	U. Mjeksise	U.Elbasanit
II	Shpenzime personeli	30,818,187	270,677,665	197,801,923	102,501,170	121,205,215	14,217,231	135,020,512
2.1	Paga	20,570,737	217,580,517	181,595,929	99,669,834	96,077,620	7,569,056	97,962,411
2.2	Honorare + Te tjera shperblime per personelin	7,527,963	20,430,181	4,734,855	20,000	5,713,066	5,071,537	30,520,378
2.3	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	141,852	19,741,721	6,291,597	322,377	11,776,954	1,333,383	0
2.4	Dieta Udhetime	604,464	12,427,542	2,434,292	1,893,959	5,549,125	243,255	6,537,723
2.5	Pagesa anetaret e bordit administrativ(+ Senati)	1,973,171	497,704	2,745,250	595,000	2,088,450	0	0
III	Investime	13,924,775	109,673,526	27,955,928	1,180,880	10,967,637	0	3,144,215
3.1	Rikonstruksion i ndërtesave shkollore	1,181,730	3,908,785	19,395,463	136,680	7,444,077	0	1,581,000
3.2	Pajisje pastrimi	0	0	0	0	0	0	0
3.3	Mjete transporti	0	0	0	0	0	0	0
3.4	Mjete dhe pajisje teknike	12,743,045	88,023,341	0	685,200	3,053,160	0	1,563,215
3.5	Pajisje zyre dhe orendi të tjera	0	17,741,400	8,560,465	0	470,400	0	0
3.6	Studime dhe kërkime	0	0	0	359,000	0	0	0
IV	Blerje mallrash	78,973,545	49,208,207	27,078,489	13,569,585	20,366,050	945,565	9,622,766
4.1	Energji elektrike	778,543	11,839,051	10,825,336	2,951,868	3,410,484	578,172	4,492,658
4.2	Karburant dhe vaj	0	8,699,903	3,575,100	575,236	28,114	0	176,264
4.3	Ujë	27,270	1,905,034	125,383	438,329	1,137,496	0	3,510,056
4.4	Ngrohje + Pastrim	4,123,895	0	0	3,284,933	2,290,540	0	0
4.5	Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	0	3,401,973	4,258,225	4,116,840	0	0	288,520
4.6	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	227,196	184,290	2,953,135	408,900	108,000	0	15,000
4.7	Libra dhe publikime profesionale	47,502	310,800	757,494	28,800	0	0	807,600
4.8	Materiale dhe shërbime operative	0	0	454,680	1,764,679	0	358,893	6,000
4.9	Pajisje Informatike	72,586,136	22,706,952	4,129,136	0	13,391,416	0	326,668
4.10	Materiale të tjera	1,183,003	160,204	0	0	0	8,500	0
V	Sigurimi i shërbimeve	67,484,487	44,097,263	20,659,681	18,712,156	17,257,713	8,002,921	28,258,424
5.1	Posta dhe shërbimi korrier	115,841	126,363	25,860	16,580	28,035	528,250	29,765
5.2	Telefon dhe internet	469,765	2,145,950	308,501	127,096	238,797	59,580	504,336
5.3	Pastrim dhe gjelbërim	0	0	0	0	0	0	0
5.4	Shërbime të tjera transporti	91,688	1,920,935	621,780	1,405,405	114,225	0	369,047
5.5	Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	39,078,595	24,100,698	6,380,432	12,178,968	14,385,408	2,330,056	18,688,984
5.6	Shërbime të tjera	2,748,980	1,156,405	0	3,141,468	0	96,740	1,224,572
5.7	Aktivite sociale per personelin (dhe pjesmarje ne evente e konferenca)	297,550	1,996,598	1,446,740	534,840	175,188	4,126,008	778,280
5.8	Mirëmbajtje ndërtesash	21,064,748	794,264	9,640,260	0	2,316,060	501,537	2,215,160
5.9	Instalim dhe mirembajtje rrejtesh informatike	2,444,620	11,086,050	915,384	683,837	0	49,950	4,448,280
5.10	Mirëmbajtje të tjera	1,172,700	770,000	1,320,724	623,962	0	310,800	0
VI	Transfera dhe Subvencione	1,282,096	7,372,505	61,429,730	2,274,630	800,927	1,020,443	1,216,176
6.1	Tranferata për projekte	0	3,316,273	387,629	239,630	327,600	894,914	109,862
6.2	Kuota Antaresimi	60,048	2,503,487	418,000	0	100,000	117,326	163,500
6.3	Komisione Bankare	1,222,048	1,552,745	60,624,101	2,035,000	373,327	8,203	942,814
VII	Të tjera	11,653,104	56,355,568	46,417,038	40,210,980	34,665,440	24000	72,826,937
7.1	Mbështetje e nxënësve të dalluar dhe bursa studimi	0	56,355,568	43,639,262	39,543,000	34,665,440	0	72,826,937
7.2	Shpenzime gjygesore	11,653,104	0	2,777,776	667,980	0	24,000	0
	Totali	204,136,194	537,384,734	381,342,789	178,449,401	205,262,982	24,210,160	250,089,030

9. KONTRATA DHE KLIENTË TË UNIVERSITETEVE

Universiteti i Tiranës

UNIVERSITETI I TIRANËS

- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
Emri UNIVERSITETI I TIRANËS
Adresa Bly: "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë
Tel/Fax Tel. +35542258446
E-mail s_dafa@unitir.edu.al
Faqja në Internet www.unitir.edu.al
- Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur.
- Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Rikonstruksion i Godinës A-B të Fakultetit të Ekonomisë".

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 182/289

Buletini Nr. 39 datë 30 Shtator 2019

Agjencia e Prokurimit Publik

- Numbri i referencës së procedurës/lotit: REF-28172-06-24-2019.
- Fondi limit: 364,008,697 (treqind e gjashtëdhjetë e katërmilion tetë mijë gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSh.
- Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opsionet dhe nënkontraktimin): 408,923,397 (katërqind e tetë mijë nëntëqind e njëzet e tremijë treqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë me TVSh.
- Data e lidhjes së kontratës: 20.09.2019.
- Emri dhe adresa e kontraktorit/nënkontraktorit:
Bashkimi i Opetiorëve Ekonomikë "ULEZA NDERTIM" shpk përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nga Z. Ndue Shpami, me adresë Njesia bashkiake nr 5, Rruga Zef Jubani, ndertesa 15, Hyrja 19, Ap 1, kodi postar 1019, Tiranë, me NIPT J679029280,
"AGRI CONSTRUCTION" shpk përfaqësuar nga Z. Petrit Patushi, Administratori i shoqërisë, me adresë Rruga e Dibrës, Ish truproja e shkollës Skënderbej, Tiranë, me NIPT K01725001F,

transaksione ndaj kompanisë Divitech me vlerë totale 78,065,476 lekë të bëra në zëra të ndryshëm dhe justifikime të ndryshme, disa prej tyre të përfshira dhe në kategorinë e gabuar. Divitech është dhe kompania që ka përfituar dhe vlerën më të madhe nga Universiteti i Tiranës.

Kompania Tony Security mban vendin e dytë për vlerën më të madhe të përfituar nga UT prej 39,078,595 lekësh të bërë në 10 transaksione në zërin e ruajtjes dhe sigurimit të ndërtesave.

UT ka shpenzuar në periudhën e monitorimit 405.657.036 lekë, apo 3.2 milion euro, për rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash ku përfshihet rikualifikim i oborrit të Histori - Filologjikut në vlerën 170.000 euro dhe rikonstruksion i Fakultetit të Ekonomisë në vlerën 2.9 milion euro.

Sa i përket klientëve periodikë të universiteteve, UT ka kryer plot 30 transaksione me një vlerë jo shumë të madhe prej 388,181 lekë për shpenzime telefonie ndaj kompanisë Albelekom dhe 12 transaksione me vlerën 4,123,895 lekë janë kryer në drejtim të Bolvoil për lëndë djegëse. Ndërkohë një transaksion është kryer ndaj kompanisë BNT me vlerën 11,523,000 lekë me justifikimin shpenzime gjyqësore duke mos dhënë asnjë detaj tjetër mbi të. Janë realizuar 17

Universiteti Politeknik i Tiranës

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
Emri Universiteti Politeknik i Tiranës
Adresa sheshi "Nene Tereza", nr. 4, Tiranë
Personi përgjegjës Aderaldo MEMA
E-mail aderaldo.mema@yahoo.com
Nr.tel 355 695638500
Faqja në Internet www.upt.al
- Lloji i procedurës: Negocim pa shpallje prapaprake te njoftimit te kontrates
- Objekti i kontratës Riparime te Dentimeve te Shkaktuara nga Termi ne Godinat ne Administrim te FIN&FAU
- Numri i referencës së procedurës/lotit REF-38929-10-10-2019
- Fondi limit 2,573,000 (dy milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tremijë) leke (pa TVSH).
- Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opcionet dhe nenkontraktimin):
Vlera 3,072,000 (tremilione e shtatëdhjetë e dymijë)(me TVSH) Monedha Lekë
- Data e lidhjes së kontratës 23.10.2019
- Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit
Emri MELA. sh.p.k Nr. NIPT K62320011G
Adresa Njësia bashkiake nr.9, rruga"MalikMuço", ndertesa 6, hyrja 4, ap 14, Tiranë.
- Informacion mbi kontratën fillestare (në rastin e shtesës së kontratës)
1. Numri i kontratës fillestare Data e lidhjes së Kontratës fillestare
2. Kontrata fillestare është lidhur në përfundim të zhvillimit të një procedure me mjete elektronike
Po Jo
3. Numri i referencës së procedurës së zhvilluar me mjete elektronike/lotit _____
4. Emri dhe NIPTI i kontraktorit _____
5. Vlera totale përfundimtare e kontratës fillestare/ lotit:
Vlera _____ (me TVSH) Monedha _____

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 322/407

Ndaj kësaj kompanie UPT ka kryer gjithsej 11 transaksione me vlerën totale 108,005,242 lekë apo rreth 878 000 euro. Ndërkohë 8 transaksione janë kaluar ndaj Myrto Security për shërbimin e rojeve private me vlerë 21,605,698 lekë.

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANES

- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor
Emri Universiteti Politeknik i Tiranës
Adresa sheshi "Nene Tereza", nr. 4, Tiranë
Personi përgjegjës Aderaldo MEMA
E-mail aderaldo.mema@yahoo.com
Nr.tel 355 695638500
Faqja në Internet www.upt.al
- Lloji i procedurës se prokurimit: Kerkese per Propozim
- Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadërBlerje karburanti per nevoja te UPT.
- Numri i referencës së procedurës/lotitREF-23296-05-22-2019
- Fondi limit7,250,000 (shtatë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) leke pa TVSH.
- Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotet opcionet dhe nenkontraktimin):
Vlera 8,699,903(tetmilion e gjashtëqind e nentëdhjetë e nentemijë e neteqind e tre)lekë.(me TVSH) Monedha LEKË
- Vlera e nenkontraktimit _____ me Tvsh Monedha _____
- Data e lidhjes së kontratës01.07.2019
- Emri dhe adresa e kontraktorit /nenkontraktorit
Emri "A&T" sh.a
Adresa "Rruga "Ibrahim Rugova",Kulla "SkyTower",Kati 7,Apartmenti Nr.3, Tiranë
Nr. NIPT L32320008H

UPT ishte nga universitetet e vetme që paguante sigurim të pasurisë nëpërmjet një kontrate me kompaninë Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Groupe. Vetëm në 8 muaj ndaj kësaj kompanie ky universitet ka paguar rreth 20.000 euro për sigurim pasurie. Referuar ngjarjeve të fundit ku si pasojë e një tërmeti disa godina u dëmtuan, Qendresa Qytetare e thelloi monitorimin për të verifikuar sa funksionale ishte kjo kontratë e lidhur mes universitetit dhe kompanisë Sigal. Në 23 Tetor 2019 UPT ka nënshkruar kontratë me kompaninë MELA sh.p.k me objekt "Riparim i dëmtimeve të shkaktuara nga tërmeti në godinën nën administrim të FAU-FIN në vlerën 24.000 euro. UPT ka kryer transaksionin me vlerë më të lartë ndaj kompanisë Divitech me vlerë prej 22,178,400 lekësh me përshkrimin pajisje elektronike.

Ky universitet vijon të mbajë vendin e parë për sa i përket shpenzimeve për karburant, ku vetëm në 8 muaj ka shpenzuar 70.000 euro për blerje nafte, ose 8750 euro në muaj. Referuar edhe faktit që UPT nuk ka autobusë për ekspedita në pronësi apo godina jashtë Tiranës, shuma e shpenzuar është e pajustifikuar dhe e dyshimtë. Në këtë zë përjashtohet edhe mundësia që kjo lëndë djegëse të jetë përdorur për ngrohje pasi zëri ngrohje dhe pastrim rezulton 0 shpenzime.

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës

UNIVERSITETI ALEKSANDËR MOISIU DURRËS

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës
Adresa: Lagjia Nr. 1, Rruga e Currilave, Durrës
Tel/Fax: 069 9690077
E-mail: ervis09@gmail.com
Faqja e Internetit: www.uamd.edu.al

2. Lloji i procedurës: Kërkesë për Propozim

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Shërbim Printimi"

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-32803-08-06-2019.

5. Fondi limit 4.868.662 (katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa tvsh.

6. Vlera totale përfundimtare e kontratës (duke përfshirë lotetopsionet dhe nenkontraktimin):

5.439.271 (pesë milion e katërqind e tridhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një) lekë me TVSH.

7. Data e lidhjes së kontratës 17.09.2019.

8. Emri dhe adresa e kontraktorit/nenkontraktorit

Emri: "KALLFA" sh.p.k NIPT: J71406006Q
Adresa: Rruga "Perlat Rexhepi pallati Dulaku", Tiranë.

UAMD vijon të kryejë pagesa për perde kundër diellit, ashtu si në periudhën e parë të monitorimit, duke shpenzuar rreth 14.000 euro për këtë produkt. Rafin Company ka përfituar nga UAMD në vlerën 11,935,107 lekë të kryer në dy transaksione për rikonstrukcion të nyjave hidrosanitare dhe mirëmbajtje të objekteve ndërtimore.

Një kontratë e cila hedh hije dyshimi në mënyrën e shpenzimit të parave nga UAMD është kontrata që ka për objekt shërbimin e printimit ndaj një kompanie në vlerën 44.000 euro, vlerë me të cilën mund të ishin blerë mbi 20 printerë profesionalë dhe ti shërbenin secilit departament dhe studentëve falas.

Universiteti "Fan Noli", Korçë ka kryer 8 transaksione për Alben 2 Security Sh.p.k me vlerën 11,398,468 lekë për sigurim dhe ruajtje objekti dhe 2 transaksione me vlerën 3,860,169 lekë për lëndë djegëse për ngrohje dhe karburant ndaj AROIL Company.

Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër ka lëshuar një kërkesë ofertë për të blerë një rrufepritëse në vlerën 5,576,498.00 lekë apo 45.000 euro. Një shifër e konsiderueshme në raport me nevojat që ka universiteti dhe studentët.


Universiteti i Mjekësisë që është dhe Universiteti me shpenzimet më të ulëta, ka kryer pagesën më të lartë ndaj një kompanie të quajtur PIKCREATIVE me përshkrimin Shpenzime për Ceremoninë e Diplomimit të Studentëve, me vlerën 3,466,008 lekë.

Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan pagesën më të lartë ja ka kaluar 1 individit me inicialet F.Q në vlerën e 200.000 eurove me përshkrim pagesën e pagave të stafit. Gjithashtu ky universitet vijon të paguajë tarifa të larta për sigurimin e godinës, ku vetëm në këto 8 muaj janë kryer 6 transaksione ndaj kompanisë Kumria-1 me vlerën 18,688,984 lekë.

Nga analiza e mësipërme vihet re se universitetet janë të fokusuara tek kontratat e restaurimeve, kostot e personelit apo administratës dhe blerjet e shërbimeve rutinë, ndërkohë që në 7 universitetet e marra në shqyrtim ende mungojnë për studentët disa shërbime bazike si:

- Sistemi elektronik i studentëve
- Wi-fi falas për studentët
- Libra në biblioteka
- Fotokopje dhe printerë për studentët
- Laboratorë dhe pajisje laboratorike
- Ngrohje & Ftohje në sallat e leksionit
- Lëshim i vërtetimeve dhe dokumentacioneve në mënyrë elektronike pa pagesë

7. PORTALI U-TRANSPARENCA.AL



Në përgjigje të një ndër kërkesave kryesore të protestës së studentëve në dhjetor 2018, qeveria nxori VKM nr. 781 për garantimin e transparencës së institucioneve të arsimit të lartë, pavarësisht ekzistencës së ligjit për të drejtën e informimit dhe detyrimeve që ai parashikon për çdo autoritet publik.

Nga verifikimet e kryera nga ekipi i Qëndresës Qytetare ky portal nuk përmban të dhëna mbi shpenzimet në nivel universiteti apo rektorati por vetëm të dhëna

në nivel fakulteti, gjë që u vështirëson studentëve të kuptojnë shpenzimet totale të universitetit dhe raportin e shpenzimeve për mënyrën se si harxhohen paratë e tyre.

Një tjetër mangësi e këtij portali janë prokurimet publike, ku për vitin 2019 nuk kemi të publikuar asnjë kontratë të lidhur nga asnjë universitet, ndërkohë që nga monitorimi ynë rezultojnë dhjetëra kontrata të lidhura nga universitetet me operatorë privatë të tretë nëpërmjet procedurave të tenderimit.

Ndërsa sa i përket vendimeve të organeve administrative dhe akademike, janë publikuar vetëm ato vendime që kanë lidhje me bursat dhe tarifat, por jo vendime me efekt financiar dhe legjislativ brenda universitetit.

Njëkohësisht ky portal duhet të përmbante të gjitha CV-të e pedagogëve të universiteteve sipas VKM, brenda muajit Shkurt, por ende shohim që ka shumë mangësi në këtë drejtim dhe pothuajse i gjithë materiali është i paplotë.

8. REKOMANDIME

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të zbatojë plotësisht VKM 781, dt. 26.12.2018 duke përditësuar dhe plotësuar me kategoritë që mungojnë portalin u-transparenca.al përfshi, vendimet e zbardhura të Bordeve të Administrimit, kontratat me të tretët dhe prokurimet për vitin 2019.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të inspektojë buxhetet, transaksionet dhe ofrimin e shërbimeve të universiteteve publike sipas parashikimeve të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor e të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore në raste shkeljesh.
- Universitetet publike duhet të përditësojnë dhe personalizojnë programet e transparencës në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit dhe të aplikojnë vendimmarrje financiare të hapur, me përfshirjen e studentëve e në konsultim të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Universitetet publike duhet të reduktojnë dhe reformojnë strukturat organizative të fryra duke aplikuar njëkohësisht dixhitalizimin e shërbimeve ndaj studentëve.
- Universitetet publike duhet të alokojnë më shumë para për zërat e kërkimit shkencor dhe pasurimit të bibliotekave të tyre me librat që përmban kurikula mësimore dhe më pak para për siguri, kamera dhe siguracione godinash.
- Këshillat Studentore dhe studentët aktivë të bëhen pjesë e vendimmarrjes duke verifikuar çdo blerje, çdo kontratë lidhur me të tretët dhe çdo shërbim të ofruar nga universiteti ku studiojnë.
- Këshillat Studentore dhe studentët të kërkojnë nga anëtarët e Bordit të Administrimit të propozuar prej tyre llogari periodike për çdo veprim financiar që ka ndërmarrë universiteti.



QENDRESA
QYTETARE

FRIEDRICH
EBERT 
STIFTUNG